

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE "DIVA DENTAL" Sh.p.k.**

Sot, me date 24/06/2024,

**Z. Marco Di Valentino**, shtetas Italian, lindur ne Lucerna (CHE), Itali, me 16/12/1973, banues ne: Via Fonte Vecchia Fraz. Piano, N. 6, Torricella Sicura (TE), Itali, mbajtes i dokumentit Karte Identiteti me nr.CA77647PN, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

Ne perputhje me ligjin 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ka vendosur te themeloj nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar te emertuar "DIVA DENTAL" Sh.p.k. (me poshte referuar si "Shoqeria").

**NENI 1**

**EMERTIMI**

Themelohet nje shoqeri e se drejtes shqiptare me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "DIVA DENTAL" Sh.p.k.

**NENI 2**

**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqerise ndodhet ne: Rruga 'Siri Kodra', Bulevardi i ri, Godine banimi dhe sherbimesh, Kati i 2, me numer Pasurie 8/753, Zone kadastrale 8340, Tirane.

Asambleja e ortakeve mund te themeloje filiale, seli dytesore ose njesi te tjera operative si dhe te transferoje seline e shoqerise ne nje adrese apo qytet tjetër.

**NENI 3**

**KOHEZGJATJA**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete per nje afat te pacaktuar, pervec zgjatjes ose prishjes se meparshme te saj sipas vendimit te Asamblese se Ortakeve.

**NENI 4**

**OBJEKTI**

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise:

- Shit - blerje produktesh dentare.

Pervec kesaj ne perputhje me legjislacionin shqiptar, shoqeria mund te kryeje çdo aktivitet tjetër qe lidhet me objektin e siperpermendur.

Shoqeria mund te kryeje gjithashtu te gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do te vlerësohen të nevojshme apo të dobishme per realizimin e objektit te shoqerise si dhe të blejë pjesemarrje në kapitalin themeltar të shoqerive të tjera që kane objekt te njëjtë, te ngjashem apo që lidhet me te vetin.



Shoqeria ne ushtrimin e aktivitetit te saj, do te marre te gjitha autorizimet e lejet/licencat e nevojshme prane institucioneve publike shqiptare, dhe do te mbeshetet ne rregullat dhe normat ne fuqi ne lidhje me ushtrimin e veprimtarise se saj te rregullt ekonomike.

#### **NENI 5**

##### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar eshte i perbere nga kontributi ne te holla i ortakut themelues ne vleren 1000 Lek (nje mije) lek dhe eshte i perbere nga 1 kuote.

Kapitali themeltar ndahet si me poshte:

- **Z. Marco Di Valentino**, zoteron 1 kuote, me 100% te kapitalit themeltar, me 1 (nje) pjese me vlere 1000 (nje mije) lek dhe 1000 (nje mije) lek te kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund te zmadhohet nepermjet kontributeve te reja ne para ose ne natyre, sipas vendimeve te asamblese se ortakeve te marra me shumicat te parashikuara per ndryshimin e statutit.

#### **NENI 6**

##### **ORGANET E SHOQERISE**

Organet e shoqerise perbehen nga Asambleja e ortakeve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise e cila vepron ne perputhje me Statutin e shoqerise dhe legjislacionin ne fuqi.
- Asambleja e Pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise.
- **Z. Marco Di Valentino**, shtetas Italian, lindur ne Lucerna (CHE), Itali, me 16/12/1973, banues ne Via Fonte Vecchia Fraz.Piano, N 6, Torricella Sicura (TE), Itali, mbajtes i dokumentit Karte Identiteti me nr. CA77647PN, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar, caktohet Administrator i shoqerise.
- Kohezgjatja e mandatit te Administratorit/eve eshte 5 (pese) vjet, me te drejte ri-emerimi.

#### **NENI 7**

##### **LEGJISLACIONI I APLIKUESHEM**

Aktiviteti i shoqerise do te rregullohet nga dispozitat e statutit te shoqerise, si dhe nga te gjitha dispozitat ligjore ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

#### **NENI 8**

##### **DISPOZITA FINALE**

Ky Akt Themelimi hartohet ne 2 (dy) kopje origjinale ne gjuhen Shqipe dhe ate Italiane me vlere te njejte ligjore. Per çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi dhe/ose zbatimi i këtij Akt Themelimi, versioni shqip do të jetë i detyrueshëm dhe do të ketë përparësi.

Permbajtja e Aktit te Themelimit u lexua dhe nenshkrua nga Ortaku themelues i shoqerise duke autorizuar *Administratorin Z. Marco Di Valentino*, per te kryer te gjitha veprimet e nevojshme per regjistrimin e shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit (QKB) ne Tirane.

#### **ORTAKU THEMELUES**

**MARCO DI VALENTINO**

MARCO DI VALENTINO  
